



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/03-46437 dt. 20/09/ 2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë:
13.09.2024

Mbledhjen e kryesoi anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal: Gani Krasniqi

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
2. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake

Prezent gjatë mbledhjes se rregullt ishin 30 anëtar të Kuvendit Komunal, Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Nënkryetari i komunës Arben Shala si dhe stafi i kryetarit.

Gani Krasniqi , E hapi mbledhjen e Kuvendit të Komunës, fillimisht në bazë të nënshkrimeve në listën përkatëse konstatoj se **prezent ishin 30 anëtar**, andaj kuorumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me punë, dhe njoftoj me rendin e ditës:

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime **Gani Krasniqi** hodhi në votim rendin e ditës ku të pranishëm ishin 30 anëtar dhe të gjithë votuan në mënyrë unanime.

Gani Krasniqi sqaroj mënyrën e votimit, sipas UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 2009/01 PËR PROCEDUREN E ZGJEDHJES DHE PËRGJEGJËSITË E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS, neni 3 pika 2 e sqarën se votimi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit Komunal bëhet me vota të fshehta.

Kuvendi i Komunës shkoj me 15 min pauzë për arsye të përgatitjes së fletvotimeve
Pas 15 min. pauzë filloj me procedurat e votimit, votimi i zgjedhjes së kryesuesit bëhet me vota të fshehta

Fillon regjistrimi i votimit

Kryetari i komisionit Mehedin Salihu konstatoi se të pranishëm janë 31 anëtarë të kuvendit dhe votimi për kryesues filloi,

Komisioni ka konstatuar se nga 31 votues një votë ka qenë e pavlefshme

Mehedin Salihu- Kryetar i Komisionit pas procedurës se votimit për zgjedhjen e kryesuesit konstatoj se me rundin e parë u zgjodh për Kryesues të Kuvendit Komunal Bekim Lestrani me 17 vota, kunder Arigon Sinanit i cili kishte 13 vota, dhe një votë e pavlefshme

Me 17 vota për, Bekim Lestrani nga Partia Demokratike e Kosovës, është zgjedhur kryesues i kuvendit komunal deri në përfundim të mandatit 4 (kater) vjeçar, njejtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Pas zgjedhjes së tij me shumicë votash, Bekim Lestrani ka falënderuar kryetarin Lladrovci për besimin e dhënë dhe përkrahjen e asamblistëve për të udhëhequr kuvendin komunal.

Në seancë morën pjesë 31 anëtarë, dhe komisioni për mbikëqyrjen e procesit të votimit u përkujdes që procesi votimit të jetë konform legjislacionit në fuqi.

Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës- **2. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake**

Egzona Tërdevci- sa i përket kësaj pike po më vjen mirë që qeverisja ka reflektu te buxheti i ulët që ka nda për ujesjellës në vazhdimësi pra ka qen 200.000 euro dhe ka bë një bartje prej më shumë se 400.000 euro sado që është vonë mendoj që është njëri prej vendimeve të pakta të qëlluar që i keni, VV e mbështet këtë propozim.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi i mbledhjes hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, 1 votë abstenim, u miratua pika e dytë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Procesmbajtëse:


Indira Olluri Thaçi



Kryesuesi i mbledhjes


Gani Krasniqi